



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 892/6 Prot.

Tiranë, më 30.11.2023

V E N D I M

Nr.94, datë 30.11.2023

Mbi përfundimin e procesit të inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë, në lidhje me veprime administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Dimal dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të procesit të inspektimit të nisur me Urdhrin nr. 82, datë 27.10.2023, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është rregjistruar informacioni me shkresat nr. 892 prot., datë 28.09.2023, nr. 929 prot., datë 06.10.2023 dhe nr. 892/2 prot., datë 23.10.2023, i paraqitur nga nëpunësja ***** me detyrë “*Specialist Jurist*”, Sektori për Burimet Njerëzore dhe Shërbimet Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Bashkisë Dimal, përmes së cilit ngrihen pretendime për shkelje të dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë aplikimit të disa prej instituteve të tij.

Konkretisht, në përmbajtjen e informacionit të mësipërm parashtrohen pretendime, për zbatim të gabuar të legjislacionit të shërbimit civil, në këto drejtime:

a) Punonjësja ***** është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist Jurist*”, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse, me aktin nr. 144/17 prot., datë 29.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Dimal.

Gjatë periudhës së provës, pretendon se, eprori direkt që në këtë rast përkon me përfaqësuesin e njësisë përgjegjëse, në kundërshtim me kërkesat e nenit 24, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2025, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, nuk ka dërguar pranë ASPA-s emrin e nëpunëses në periudhë prove, për ndjekjen e trajnimit të detyrueshëm.

Për më tepër, në kundërshtim me kërkesat e këtyre akteve ligjore dhe nënligjore, nuk ka caktuar nëpunësin më të vjetër civil, nën kujdesit dhe udhëzimet e së cilit, duhet të punonte nëpunësja në periudhë prove *****.

b) Titullari i institucionit me Urdhrin nr. 567, (nr. 2719/1 prot.), datë 30.08.2023, *“Dhënie mase disiplinore”*, në mbështetje të akt-konstatimit nr. 2719 prot., datë 30.08.2023, të hartuar nga Supervizori i disiplinës, (pozicion i rregulluar me kod pune, në strukturën e bashkisë), ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore *“Vërejtje”*, për nëpunësen ***** me detyrë *“Specialist Jurist”*, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse, me motivacion: *“Thyerje e disiplinës në punë, gjatë orarit të punës, është larguar pa përcaktuar destinacionin në librin e hyrje - daljeve dhe pa urdhër për arsyen e lëvizjes”*, dhe nuk ka njoftuar nëpunësen për fillimin e procedurës disiplinore.

Sa i takon masës disiplinore të dhënë, nëpunësja ngre pretendimin se, nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në kreun X, *“Disiplina në shërbimin civil”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe dispozitat e cituara në kreun II, *“Procedura disiplinore”*, të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, të detyrueshme për tu ndjekur nga ana e eprorit direkt, në rastin e zbatimit të institutit të disiplinës, në shërbimin civil, dhe organi i cili ka nxjerrë aktin, titullari i bashkisë ka vepruar në mungesë të kompetencës lëndore.

Gjithashtu, nëpunësja pretendon se, ka lëvizur për arsye pune dhe për këtë ka njoftuar eprorin e saj, Drejtorin e Burimeve Njerëzore.

Për këtë arsye, nëpunësja ***** me shkresën nr. 2917 prot., datë 14.09.2023, i është drejtuar kryetares së bashkisë, ku ka kërkuar t'i vihet në dispozicion kopje e dokumentacionit të procedurës disiplinore të nisur në ngarkim të saj, si dhe ka kundërshtuar Urdhrin nr. 567, (nr. 2719/1 prot.), datë 30.08.2023, si një akt absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kundërshtim flagrant me ligjin.

c) Personi i autorizuar për menaxhimin e sistemit të bashkëqeverisjes *“Shqipëriaqëduam.al”*, me shkresën nr. 2803 prot., datë 06.09.2023, drejtuar kryetares së

bashkisë, ka propozuar dhënien e masës disiplinore “Paralajmërim”, për nëpunësen *****, për shkak të “mos realizimit të detyrave të ngarkuara”.

Në vijim, Drejtori i Burimeve Njerëzore me shkresën nr. 2905 prot., datë 13.09.2023, “Propozim për masë disiplinore, bazuar në Komisionin Disiplinor”, në cilësinë e eprorit direkt, i ka kërkuar titullarit të institucioni, në mbështetje të nenit 57, pika 3, germa c) dhe ç), të ligjit nr. 152/2013, nisjen e ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses *****, duke argumentuar se, masën disiplinore “vërejtje” të propozuar nga inspektori i disiplinës dhe të dhënë me aktin nr. 567 prot., datë 30.08.2023, nëpunësja ***** e ka kundërshtuar duke parashtruar pretendime të rreme, pasi nuk provohet se, nëpunësja ka njoftuar eprorin për lëvizjen në këtë datë, për më tepër nëpunësja gjatë orarit të punës ka një komunikim të papërshtatshëm me eprorët, kolegët dhe publikun.

Më tej, kryetarja e bashkisë, me urdhrin nr. 594, (nr. 2905/1 prot.), datë 14.09.2023, mbështetur në propozimin e eprorit, ka ngritur Komisionin e Disiplinës dhe ka kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses në fjalë. Me shkresën nr. 2905/3 prot., datë 14.09.2023, “Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”, Drejtori i Burimeve Njerëzore ka njoftuar nëpunësen për nisjen e ecurisë disiplinore, duke i parashtruar shkeljet disiplinore të pretenduara në ngarkim të saj, si dhe duke e njohur me të drejtën për të paraqitur me shkrim sqarimet rreth shkeljes së pretenduar, jo më vonë se 5 ditë para ditës së shqyrtimit të çështjes, e cila është vendosur të jetë në datën 21.09.2023, ora 10:30.

Në përfundim të ecurisë disiplinore, Komisioni i Disiplinës ka nxjerrë vendimin nr. 8, (nr.2905/10 prot.), datë 27.09.2023, “Për dhënie mase disiplinore”, me të cilin ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për nëpunësen në periudhë prove *****, bazuar në nenin 57, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në bazë dhe për zbatim të këtij vendimi, kryetarja e bashkisë, me aktin nr. 623, (nr.3112 prot.), datë 29.09.2023, ka dhënë masën disiplinore “largim nga shërbimi civil”, për nëpunësen në periudhë prove *****.

Sa i takon fakteve të referuara më sipër, nëpunësja *****, parashtron se, të drejtën për të propozuar nisje të ecurisë disiplinore në ngarkim të saj nuk e kanë zyrtarët të cilët kanë paraqitur propozimet e evidentuara në njoftimin për fillimin e ecurisë disiplinore; në lidhje me shkeljet e pretenduara, nëpunësja sqaron se, asnjë prej tyre nuk qëndron dhe nuk është e provuar.

Gjithashtu, nëpunësja pretendon parregullsi ligjore, në drejtim të aplikimit të pikës 13, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, pasi nuk i janë vënë në dispozicion aktet të cilat dokumentojnë shkeljet e pretenduara të kryera prej saj.

Sa i takon përbërjes së Komisionit Disiplinor të ngritur me urdhrin nr. 594, (nr. 2905/1 prot.), datë 14.09.2023, të kryetares së bashkisë, nëpunësja ka argumentuar se, nuk janë respektuar kërkesat e nenit 59, “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinor”, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe përcaktimet e pikës 3, kreu 1, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave.

Sa i takon, masës disiplinore të dhënë “Largim nga shërbimi civil”, (neni 58, germa ç), parashtron se, nuk është në përpjestim me shkëljen e pretenduar nga eprori direkt i saj, për shkelje të nenit 57, pika 3, germa c) dhe ç), të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, (shkresa nr.2905 prot., datë 13.09.2023), pasi këto **shkelje klasifikohen si shkelje të rënda** dhe në mbështetje të nenit 60, pika 4, **jepet masa disiplinore e parashikuar në germën b) dhe c), të nenit 58**, që janë: “b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj; c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”.

Për të gjitha këto arsye, nëpunësja ***** informon Komisionerin, me qëllim që të verifikohen dhe vlerësohen të gjitha veprimet administrative të kryera nga nëpunësit e ngarkuar prej ligjit me detyra specifike gjatë një ecurie disiplinore, si edhe të kontrollohet veprimtaria e organizmave ligjore, të tilla si Komisioni i Disiplinës, apo eprori direkt, si në drejtim të zbatimit të procedurave ligjore, ashtu edhe në drejtim të respektimit të kërkesave ligjore të parashikuara në dispozitat e ligjit për nëpunësin civil dhe në aktet nënligjore përkatëse.

Në vijim, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara në informacionin e ardhur nga nëpunësja ***** ashtu si u evidentua më sipër, vlerësoi se kishte dyshime të arsyeshme në lidhje me parregullsi në drejtim të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe për këtë arsye, me urdhrin nr. 82, (nr. 1041 prot.), datë 27.10.2023, ka nisur verifikimin e ligjshmërisë së procedurës disiplinore të ndjekur nga eprori direkt dhe komisioni disiplinor, në përfundim të së cilës, me aktin nr. 623, (nr.3112 prot.), datë 29.09.2023, është dhënë masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.

Në zbatim të pikës 3, të urdhrin nr. 82, datë 27.10.2023, inspektorët e ngarkuar për verifikimin e këtij rasti, u paraqitën pranë institucionit dhe sipas akt konstatimit të mbajtur pranë këtij institucioni, administruan dokumentacionin në të cilën materializohet procedura e ndjekur për emërimin e punonjësës, si dhe procedura disiplinore e ndjekur në këtë rast.

Nga analiza e materialeve shkresore të administruara si dhe dokumentacioni bashkëlidhur informacionit të nëpunësit, situata evidentohet si më poshtë:

Së pari, sa i përket detyrave që duhet të përmbushen nga palët në një marrëdhënie punësimi gjatë periudhës së provës, rezulton se, në përfundim të procedurës së konkurrimit pranë nëpunësin civil, me urdhrin nr. 2144/17 prot., datë 29.09.2022, të kryetares, kandidatja

fituese *****, është emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, si nëpunës civil në periudhë prove.

Sipas dokumentacionit të administruar, konstatohet se, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe kreut VI, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar, gjatë periudhës së provës nëpunësja nuk është regjistruar për të kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s; gjithashtu, gjatë të gjithë kësaj periudhe, nuk i është bërë e ditur nëse, nga eprori direkt është caktuar një nëpunës më i vjetër civil, nën kujdesin e të cilit duhet të kryente detyrat.

Vetëm, gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të saj, nëpunësja *****, është njohur me aktin nr. 3112/1 prot., datë 29.09.2023, “*Mendim me shkrim për NCPP ******”, i nënshkruar nga Rajmonda Shuka, me detyrë “*Sekretar i Përgjithshëm*”, i komanduar, akt i cili provohet se, është nxjerrë pasi ka dalë akti i kryetares, për masën disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, për nëpunësen *****, i regjistruar me nr. 3112 prot., datë 29.09.2023.

Në të njëjtën ditë, datë 29.09.2023, është nënshkruar nga zyrtari raportues ***** (Sekretar i Përgjithshëm, i komanduar) dhe zyrtari kundërfirmues titullari i institucionit, formulari vlerësimit për periudhën e provës, që përkon me periudhën 29.09.2022 deri 29.09.2023, me të cilin nëpunësja nuk është njohur, pasi nuk e ka nënshkruar. Në këtë rast, dy zyrtarët vlerësues kanë vepruar në kundërshtim të hapur me kërkesat e kreut XI, “*Vlerësimi i nëpunësit civil*”, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 109, datë, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”.

Sa më sipër, mbështetur në germën a), pika i) dhe ii), të nenit 108, si dhe nenit 110 dhe 111, të Kodit të Procedurave Administrative, akti nr. 3112/1 prot., datë 29.09.2023, “*Mendim me shkrim për NCPP ******”, si dhe formulari i vlerësimit për periudhën e provës, duhet të konstatohen si akte absolutisht të pavlefshëm, nga vetë organi publik i cili i ka nxjerrë aktin duke i anuluar ato.

Në mbështetje të dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, të cilat normojnë marrëdhënien e punësimit gjatë periudhës së provës, eprori direkt i nëpunëses *****, duhet të kishte marrë masa, për respektimin e tyre, duke caktuar nëpunësin më të vjetër, në kujdestari të së cilit do të punonte nëpunësja për të gjithë periudhën e provës; regjistrimin e nëpunëses për ndjekjen e trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA-s; si dhe vlerësimin e rezultateve në punë në fund të periudhës së provës, sipas procedurave të kërkuara.

Së dyti, në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së procedurës për dhënie e masës disiplinore “*Vërejtje*”, ndaj nëpunëses *****, me Urdhrin nr. 567, (nr. 2719/1 prot.), datë 30.08.2023, të kryetares së bashkisë Dimal, konstatohet se: në nenin 57, “*Përgjegjësia për masat disiplinore*”, përcaktohet përgjegjësia e nëpunësit civil për shkeljen me faj të detyrimeve sipas ligjit, si edhe kategorizimi i shkeljeve në:

a) shkelje shumë të rënda; b) shkelje të rënda; c) shkelje të lehta.

Më tej, në pikën 2, të këtij neni, parashikohet kategorizimi i shkeljeve shumë të rënda; në pikën 3, i shkeljeve të rënda dhe në pikën 4, i shkeljeve të lehta.

Ndërsa, në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, parashikohen “Llojet e masave disiplinore” të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, në një rast kur evidentohen shkelje disiplinore:

“Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

a) vërejtje;

b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;

c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.

ç) largim nga shërbimi civil”,

dhe në nenin 59, të këtij ligji, përcaktohet kompetenca dhe procedura për dhënien e tyre. Sipas pikës 2, të kësaj dispozite, masa e parashikuar në germën a) të nenit 58, jepet nga eprori direkt i nëpunësit, ndërsa masat e parashikuara në germat b), c) dhe ç) jepen nga Komisioni Disiplinor, për çdo nëpunës civil në institucion.

Në referim të pikës 10, të nenit 59, të ligjit në fjalë, është parashikuar se, Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregullat e hollësishme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor. Ky detyrim ka gjetur zbatim me miratimin e Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar.

Konkretisht, në aktin nënligjor që rregullon disiplinën në shërbimin civil, (VKM nr.115/2014), në kreun I “Organet Disiplinore”, pika 1, përcaktohet se:

“Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt”.

Sa i takon procedurës që duhet të ndiqet nga ana e organeve disiplinore, në rastin konkret, nga ana e eprorit direkt, pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, i ndryshuar, parashikojnë të gjitha hapat e kërkuar për nisjen e ecurisë disiplinore nga eprori direkt, kur shkelja disiplinore konsiderohet e lehtë; njoftimin me shkrim të nëpunësit, duke e njohur me faktin e pretenduar si shkelje disiplinore; faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të tij; si dhe duke i dhënë mundësi nëpunësit të mbrohet, të paraqesë prapësimet dhe prova për të provuar se nuk ka kryer ndonjë shkelje disiplinore me faj.

Vetëm në përfundim të këtij procesi kompleks, eprori direkt në mbështetje të të gjithë akteve të administruara gjatë procedurës së hetimit disiplinor, duhet të marrë një vendim të argumentuar, të mbështetur në prova, nëse nëpunësi e ka kryer ose jo shkeljen dhe në rastet kur ekziston elementi i fajësisë për shkeljen e kryer, jepet masa disiplinore.

Kjo procedurë që duhet të ndiqet gjatë ecurisë disiplinore, e cituar në VKM nr.115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar, në mënyrë edhe me të detajuar për secilën fazë të saj parashikohet në Udhëzimin nr. 01, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Elementet kryesorë proceduralë dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, të cilit organi i disiplinës duhet ti referohet.

Në mbështetje të dokumentacionit dhe sqarimeve të dhëna nga institucioni, rezulton se, në rolin e eprorit direkt të nëpunëses *****, referuar strukturës dhe organikës së institucionit, miratuar me Urdhrin nr. 50, datë 07.03.2023, të kryetares, për shkak të pozicionit vakant të “Përgjegjësit për Burimet Njerëzore dhe Shërbimet Mbështetëse”, është “Drejtori i Burimeve Njerëzore, Prokurimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse”, që provohet se, nuk ka ndjekur hapat ligjorë të kërkuar gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunëses, pasi nuk provohet me dokumentacionin përkatës.

Gjithashtu, akti i dhënies së masës disiplinore “Vërejtje” është nxjerrë nga titullari i bashkisë Dimal, në mungesë të kompetencës lëndore të këtij organi.

Në këto kushte, Urdhri nr. 567, (nr. 2719/1 prot.), datë 30.08.2023, “Për dhënie masë disiplinore”, i kryetares të bashkisë Dimal, me të cilën i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, nëpunëses *****, me detyrë “Specialist Jurist”, mbështetur në germen a), pika i) dhe ii), të nenit 108, i cili parashikon se: “Një akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ...”, si dhe nenit 110 dhe 111, të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të konstatohet si një akt absolutisht i pavlefshëm, nga vetë organi publik i cili e ka nxjerrë aktin dhe ta anullojë atë.

Së treti, në lidhje me pretendimin e nëpunësit, në lidhje me zyrtarët e ngarkuar nga ligji për nisjen e procedimit disiplinor në rastin e shkeljeve të rënda dhe shumë të rënda, si dhe përbërjen e Komisionit të Disiplinës, konstatohet se, me Urdhrin nr. 594, (nr. 2905/1 prot.), datë 14.09.2023, nga ana e titullarit të institucionit, është ngritur Komisioni Disiplinor me përbërje:

1. ***** – Nëpunësi më i lartë civil në institucion;
2. ***** – Eprori direkt i nëpunësit për të cilin fillon procedura;
3. ***** – Nëpunësi më i vjetër civil në institucion;
4. ***** – Nëpunësi më i vjetër i njësisë (në profesion)

5. ***** – Nëpunës i Burimeve Njerëzore

Referuar dispozitave ligjore dhe nënligjore, të përmendura më lart, të cilat normojnë institutin e disiplinës në shërbimin civil, konkretisht, VKM-së nr.115/2014, në kreun I, “*Organet Disiplinore*”, pika 1, përcaktohet se:

“Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt”.

Ndërsa në pikën 3, të këtij kreu, sanksionohet se:

“Për institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet, komisioni disiplinor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka përbërjen e mëposhtme:

- a) nëpunësin më të lartë civil në atë institucion;*
- b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;*
- c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion;*
- ç) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;*
- d) nëpunësin më të vjetër civil të njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.”*

Në rastin konkret, po të analizojmë përbërjen e Komisionit Disiplinor, të materializuar në urdhrin nr. 594, (nr. 2905/1 prot.), datë 14.09.2023, rolin e secilit prej tyre në këtë organ disiplinor dhe se si paraqitet ligjshmëria e ndërtimit të këtij mekanizmi në raport me kërkesat e ligjit, konstatohet se:

- ✓ Sipas pikës 3, të kreut I, të VKM-së nr. 115/2014, parashikohet se rolin e Kryetarit të KD, e mban nëpunësi më i lartë civil i institucionit, që në rastin konkret, është sekretar i përgjithshëm, i cili me urdhrin nr. 1017/5 prot., datë 15.04.2023, të kryetares **është i komanduar në këtë detyrë dhe nuk gëzon statusin e nëpunësit më të lartë civil në institucion**, ç’ka detyrimisht kërkon zbatimin e pikës 6, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, në të cilën parashikohet se:

*“Në rast të lindjes së nevojës së zëvendësimit të anëtarëve të KD-së, për arsye të pamundësisë apo pengesës ligjore, **zbatohen dispozitat për zëvendësimin**, të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative”.*

Më tej, ky rregullim zërthehet më hollësisht në Udhëzimin e Departamentit të Administratës Publike nr. 1, datë 02.04.2014, në seksionin B/3, pika 2, ku parashikohet shprehimisht zëvendësimi i Kryetarit të KD-së:

“Zëvendësimi i Kryetarit të KD, bëhet nga titullari i institucionit. Në rast se titullari i institucionit është njëkohësisht dhe nëpunësi më i lartë civil i institucionit dhe për rrjedhojë Kryetar i KD, zëvendësimi i tij bëhet nga eprori direkt, tek i cili ai përgjigjet.”

Në këto rrethana, ashtu si përcaktohet në këtë udhëzim, të cilit do ti referohemi për analogji, zëvendësimi i Kryetarit të Komisionit të Disiplinës në këtë rast, bëhet nga Titullari i institucionit, pasi nuk ka nëpunës më të lartë civil në institucion.

- ✓ Sa i takon anëtarit të Komisionit Disiplinor, i cili ka rolin e eprorit direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, **rezulton se është i pa përfaqësuar, pasi me aktin nr. 212, (nr. 135/5 prot.), datë 01.06.2023, të titullarit, Boriana Baro është emëruar përkohësisht në detyrë si “Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Prokurimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse”.**
- ✓ Anëtari Marije Bizdani, në rolin e nëpunësit më të vjetër civil në institucion sipas aktit nr. 309/1 prot., datë 14.02.2022, të kryetares, është **liruar nga shërbimi civil** për shkak të mbushjes së moshës për dalje në pension të plotë pleqërie. Më tej, me aktin nr.317/15 prot., datë 15.02.2022, të kryetares, është emëruar përkohësisht si *“Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financës dhe Ndhmës Ekonomike”*, për nevoja pune.
- ✓ Anëtari Danilda Lici, si nëpunësi më i vjetër i njësisë (në profesion), referuar strukturës së miratuar me urdhrin nr. 50, datë 07.03.2023, të titullarit, nuk është e emëruar në pozicion pune në njësinë ku është e emëruar nëpunësja në procedim, për më tepër, kjo anëtare komisioni nuk ka firmosur në aktet e hartuara nga ky i fundit.

Në analizë të dispozitave ligjore dhe akteve administrative të evidentuar më lart, rezulton se, thirrja e **4 anëtarëve** në përbërje të Komisionit të Disiplinës është në kundërshtim me përmbajtjen e këtyre dispozitave, si rrjedhim, Komisioni Disiplinor i ngritur me urdhrin nr.594, (nr. 2905/1 prot.), datë 14.09.2023, të titullarit të institucionit është ngritur në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë përbërjen e këtij organi, të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”.*

Në këto rrethana, referuar gremës b), të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, procesi i fillimit të ecurisë disiplinore vlerësohet si një veprim administrativ i paligjshëm dhe për pasojë organet që kanë nxjerrë aktet administrative në përmbajtje të tij, si titullari i institucionit dhe Komisioni i Disiplinës, me qëllim që të rregullojnë ligjshmërinë duhet që ti anulojnë ato, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të rregullojnë pasojat.

Së katërti, duke analizuar kërkesën për fillimin e ecurisë disiplinore, me shkresën nr. 2905 prot., datë 13.09.2023, Drejtori i Burimeve Njerëzore, në cilësinë e eprorit direkt, i ka

kërkuar titullarit të institucioni, në mbështetje të nenit 57, pika 3, germa c) dhe ç), të ligjit nr.152/2013, nisjen e ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses *****, duke argumentuar se, shkeljet e pretenduara janë **kategorizuar shumë të rënda**, çka kushtëzuar edhe ngritjen e Komisionit të Disiplinës, për ti shqyrtuar ato, ndërkohë që, në të gjitha aktet që janë paraqitur si prova për fajësinë e nëpunëses në fjalë, nuk është përcaktuar asnjë pasojë e rëndë që të jetë në proporcion me masën e kërkuar.

Për më tepër, në këtë rast, kemi zbatim të gabuar të legjislacionit të shërbimit civil, sa i takon kategorizimit të shkeljes dhe masës disiplinore të dhënë, nga Komisioni i Disiplinës, pasi shkeljet e parashikuara në **pikën 3, germa c) dhe ç), të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, klasifikohen në shkelje të rënda**, për të cilat referuar **pikës 4, të nenit 60, të këtij ligji jepet masa disiplinore e parashikuar në germën b) dhe c), të nenit 58**, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, që janë: b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj; c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.

Organet e disiplinës në momentin kur marrin vendime në lidhje me procedimin disiplinor ndaj një nëpunësi civil, duhet të kujdesen që të përcaktojnë paraprakisht shkeljet e pretenduara dhe pasojat e ardhura për shkak të tyre, me qëllim që të respektojnë parimet e përshkallëzimit dhe individualizimit të masës disiplinore, për të ruajtur një raport të drejtë të masës së dhënë me shkeljen e kryer.

Për gjithë sa u evidentuan më sipër, arrijmë në konkluzionin se, masa disiplinore *“largim nga shërbimi civil”*, dhënë me aktin nr. 623, (nr. 3112 prot.), datë 29.09.2023, nga titullari në ngarkim të nëpunëses në periudhë prove *****, është nxjerrë në kundërshtim me procedurën dhe në shkelje flagrante të ligjit, e si i tillë, në zbatim të germës a), pika ii), të nenit 108, *“Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”*, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, duhet të konstatohet si një akt absolutisht i pavlefshëm nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë.

Në vijim të hetimit të këtij rasti, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, përmes fletëthirrjes së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, nr. 424 (1580) akti, datë 30.10.2023, u njoh me faktin se më të njëjtin objekt, nëpunësja ka ngritur padi kundër institucionit Bashkia Dimal, në këto kushte, në referim të paragrafit 3, të nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i cili sanksionon se, asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata, Komisioneri vlerëson se, hetimi administrativ i këtij rasti duhet të pushohet, pasi rasti në fjalë do të zgjidhet në mënyrë përfundimtare nëpërmjet një vendimi gjyqësor ku do të rregullohen edhe pasojat.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të pushojë hetimin administrativ të nisur me urdhrin e inspektimit nr. 82, datë 27.10.2023, për shkak të ankimimit të objektit të çështjes në organet gjyqësore.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Bashkia Dimal dhe nëpunësja në periudhë prove *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha